

Seanca e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e mbajtur më 17.10.2023, në lidhje me Njoftimin nga gjyqtarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Dr. Mirjana L Lazarova Trajkovska të datës 14.10.2023, dërguar përmes rrugës elektronike në ora 22:56, si dhe Njoftimin e datës 16.10.2023 të dorëzuar në sportelin pranues të Gjykatës drejtuar kryetares së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, se nuk ka mundësi të veprojë mbi Inicativën e parashtruar nga Mile Naumovski, avokat nga Shkupi, më 23.06.2023, për të cilën është përcaktuar si gjyqtare më 03.07.2023, nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Gjyqtarja Dr. Mirjana L Lazarova Trajkovska mbi Inicativën e parashtruar më 23.06.2023 nga Mile Naumovski, avokat nga Shkupi, në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të vazhdojë të veprojë sipas saj me përgatitjen e referatit dhe Seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në afatin e caktuar ligjor dhe të vendos për çështjet juridike që janë objekt i Inicativës.

Seanca e gjyqtarëve konstaton se gjyqtarja Dr. Mirjana L Lazarova Trajkovska në periudhën e kaluar kohore, nga dita e caktimit si gjyqtare referuese për Inicativën konkrete deri në dorëzimin e Njoftimit, si gjyqtare referuese ka mundur të veprojë mbi Inicativën në fjalë dhe kishte për detyrë si gjyqtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të veprojë në mënyrë të duhur në pajtim me Rregulloren e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke marrë parasysh afatin ligjor të shënuar në nenin 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat, si dhe faktin se Iniciativa konkrete është lëndë me interes publik dhe është në interes të publikut nga dita e dorëzimit të tij në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Seanca e gjyqtarëve erdhi në përfundim se aktivitetet ndërkombëtare lidhur me nominimin e gjyqtares Dr. Mirjana L Lazarova Trajkovska nuk janë me ndikim dhe nuk paraqesin pengesë për përgatitjen me kohë të referatit për Inicativën e paraqitur, duke treguar se çdo gjyqtar i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut funksionin si gjyqtar duhet ta kryejë në pajtim me ligjet dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Seanca e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konsideron se me pranimin e Njoftimit të dorëzuar nga gjyqtarja Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska për mosveprimin mbi Inicativën, në mënyrë që tërhiqet nga procedura për veprim dhe vendimmarrje mbi iniciativa për miratim të qëndrimeve juridike parimore dhe mendimeve juridike parimore do të krijohet një precedent në punën e Seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që është në kundërshtim me praktikën e gjykatës dhe realizimin e kompetencave të Seancës së përgjithshme, si dhe me parimet e profesionalizmit, efikasitetit dhe përditësimit, sidomos kur bëhet fjalë për lëndë të karakterit të lartë publik.

**GJYKATA SUPREME
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

SEANCA E GJYQTARËVE